

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të seminarit kombëtar:

### **‘Kompatibiliteti Akademik AML - Universitet, një axhendë efektive për mbështetjen e suksesit të studentëve’**

të mbajtur në datë: 17 Qershor 2021; Ora: 09.30 - 14.30, në Univ. “I. Qemali”, Vlorë; ku morën pjesë fizikisht 70 persona dhe të tjerë on line, dolën disa përfundime e rekomandime, që kanë si synim forcimin e mbështetjes të suksesit të studentit.

1. Rritja e shkallës së bashkëpunimit ndërmjet SHML dhe IAL, duke respektuar autonominë universitare. Në këtë kuadër rekomandohet ndërmarrja e një pakete masash për rritjen e transparencës, përmirësimin e këshillimit të nxënësve dhe të trajnimit të mësuesve në SHML. Po kështu kërkohet të përmiresohet udhezimi i MASR për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të barabarta për informimin e nxënësve maturan të për ofertën akademike nga ana e IAL publike.
2. Aplikimi i kurrikulës së re në SHML, kërkon jo vetëm njohjen e ndryshimeve në IAL, por edhe bashkëveprimin institucional ndërmjet sistemit universitar dhe atij parauniversitar. Ndikimi i këtij bashkëveprimi, si pjesë edhe e monitorimit të zbatimit të kësaj kurrikule, pritet që të ketë ndikim pozitiv në të dy sistemet duke cuar në një mbështetje më të madhe të suksesit të nxënësit & studentit. Duhet të ketë një rakordim më të mirë në procesin e miratimit të kurrikulës së programeve të studimit universitare për të qenë në linjë me zhvillimet e kurrikulës në parauniversitar për të eliminuar mangësitë në njohuri në kalimin nga një sistem te tjetri.
3. Ndërmarrja e një studimi për sistemin e pranimit dhe përmirësime të mëtejshme të politikave që lidhen me të, duke përfshirë edhe një mobilitet më të lartë të studentëve të vitit të parë, konsiderohet i domosdoshëm. Në këtë kontekst shihet edhe rekomandimi për rritje të transparencës në lidhje me kapacitetet infrastrukturore të IALve dhe vlerësimin/miratimin e kuotave të studentëve, me qëllim mosdiskriminimin e disa IALve dhe mbajtjen e standardeve të unifikuara.
4. Sugjerohet rankimi i shkollave të mesme me qëllim eliminimin e diskriminimit në pranime të nxënësve që vijnë nga shkolla «të forta». Kjo mund të realizohet përmes një studimi krahasues mes rezultateve të studentëve në arsimin parauniversitar me rezultatet në përfundim të vitit të parë në arsimin e lartë.
5. Orientimi në zgjedhjen e programeve të studimit në IAL duhet të përfshijë dhe analizën e tregut të punës për të mundësuar një informacion më të plotë për maturan të që duhet të zgjedhin programin e studimit dhe në këndvështrimin e punësimit të ardhshëm. Kjo do të ndihmonte në mënyrë të konsiderueshme dhe përshtatjen e ofertës akademike me nevojat e tregut të punës.
6. Nxjerrja e Kartës së Pririteteve, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 do të mundësonte gjithashtu, një orientim më të mirë të zgjedhjes gjatë aplikimeve në IAL.
7. Në dokumentin «Paketa e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës», të miratuar me urdhër të MASR Nr. 268, datë 28.8.2020, në fushën «Vlerësimi e arritjet e nxënësit», (treguesi 3), të shtohet një përshkrues që merr në konsideratë arritjet e nxënësit në Arsimin e Lartë.
8. Në nivel sistemi, i rekomandohet ASCAL që të kërkohet një zbatim më i plotë i kërkesave të Standardit për pranimet në IAL, në procesin e vlerësimit të jashtëm. Po kështu rekomandohet që

të rritet transparenca në procedurat e ndjekura për akreditimin e programeve dhe atë institucional, duke nisur nga zgjedhja e vlerësuesve të jashtëm, deri te vlerësimi analitik i plotësimit të kriterëve e standardeve të sigurimit të cilësisë dhe i numrit të viteve të akorduara në akreditim. Procedurat e ndjekura dhe menyra e pikëzimit të vlerësimit duhet të jenë të publikuara në faqen web të ASCAL në kuadër të transparencës, të aksesueshme për të gjithë të interesuarit. Është e nevojshme që vlerësimi të kryhet përmes skedave teknike që zbërthejnë standardet me qëllim eliminimin maksimal të vlerësimeve subjektive gjatë hallkave të ndryshme të vlerësimit dhe akreditimit.

9. IAL inkurajohen që të ndërmarrin masa për rritjen e mbështetjes për studentët e vitit të parë, duke rritur cilësinë reale të studentëve, e shprehur në kalueshmëri, notë mesatare më të lartë dhe në treguesin e punësimit në profesion të studentëve. Në këtë kuadër përfshihen: hartimi i politikës së pranimit e masa strukturore, procedura të qarta për pranimin e studenteve dhe përmirësim të kriterëve të pranimit, vendosja e sistemit të tutorazhit, rritje të këshillimit e konsultimit, qasja sociale dhe njohja me maturanin, etj.
10. Rekomandohet që universitetet publike të rishikojnë strategjitë e tyre afatgjata në lidhje me vizionin e zhvillimit të universitetit në të ardhmen, sidomos universitetet jashtë kryeqytetit, duke u kthyer në qendra të zhvillimit rajonal (në linjë kjo dhe me Strategjinë e Specializimit të Zgjuar (S3) që po hartohet dhe në Shqipëri), kërkimit shkencor dhe inovacionit në përputhje me kapacitetet rajonale, burimet natyrore, etj dhe duke mbështetur biznesin në nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe inovacion. Kjo do të rriste konkurrueshmërinë dhe ofronte për të rinjtë mundësi të reja për punësimin në rajonet përkatëse në përfundim të studimeve, duke balancuar kështu zhvendosjen masive drejt Tiranës apo largimin jashtë vendit. Universiteti i Vlorës duhet të shfrytëzojë pozicionin e tij strategjik në kanalën e Otrantos për të qenë pjesë aktive në projekte madhore ndërkombëtare dhe ngritjen e qendrave të ekselencës në shkencat marine psh, që ndër të tjera do të sillnin risi dhe zhvillim në të gjithë zonën përreth dhe rritur mobilitetin akademik dhe kërkimor me vendet e tjera të rajonit Adriatiko-Jonian dhe duke e bërë edhe më atraktive edhe nga pikëpamja turistike Vlorën.
11. Rekomandohet që IAL-të publike të shfrytëzojnë hapësirat që u mundëson ligji 80/2015 në lidhje me sigurimin e financimeve nga palë të treta dhe shërbimet. Thithja e financimeve përmes këtyre mundësive do të mundësonte përmirësimin ndjeshëm të infrastrukturës didaktike dhe kërkimore, të ardhurave të pedagogëve, si dhe do të shërbente në krijimin e ambjenteve dhe shërbimeve më cilësore për studentët duke e bërë më atraktiv dhe konkurrues universitetin përkatës.
12. Nga një studim i kryer nga HEREt për periudhën (2017-2020), rezulton se:
  - a. Studentët e pranuar në një IAL, vijnë nga tipologji të ndryshme të SHML dhe kjo % është e ndryshme. Ndërsa në programin e studimit «Biologji», tipologjia e SHML është 100% gjimnaz, në fushën e Inxhinierisë kjo shifër është (93-96%), por në programe të ndryshme mund të shkojë edhe 30%. IAL duhet ta evidentojnë këtë gjendje dhe të ndërmarrin masa përkatëse që rrisin mbështetjen për studentët. Disa prej masave të rekomanduara, por duke mos u kufizuar, janë: zhvillim cikli leksioni në lëndë të caktuara, sidomos në Matematikë; shkolla verore; ndarja e studentëve në dy grupe (vecohen studentët që kanë bërë lëndë të avancuar); aplikimi i sistemit të tutorazhit; etj.
  - b. Mbi 80% e studentëve deklarojnë se programi i studimit i zgjedhur në Inxhinieri & Biologji, gjendet ndër 3 zgjedhjet e para. Duke patur parasysh edhe faktin që kriteret e pranimit njihen nga më shumë se 90% e studentëve, mund të konkludohet se sistemi i pranimit

meritë/preferencë funksionon. Nga ana tjetër duke marrë në konsideratë që këshillimi nga mësuesit rezulton 52÷62% kërkohet që të rritet shkalla e këshillimit të nxënësve në SHML. Po kështu rekomandohet përhapja e rezultateve të projekteve për trajnimin e mësuesve për këshillim në SHML.

- c. Në pikëpamje të arsyes të zgjedhjes së këtij institucioni nga studenti, cilësia e IAL. renditet nga studentët si faktori kryesor, duke u luhatur (67-52%) për Biologjinë dhe (59-53%) për Inxhinierinë, por duke patur një gradient negativ në periudhën (2017-2020). Kjo do të thotë që IAL duhet të shtojnë përpjekjet për përmirësimin e cilësisë, pasi kjo ndikon drejtpërsëdrejti edhe në pranimet në vitin e parë. Pavarësisht se faktori ekonomik ka rezultuar nga pyetësorët e studentëve me peshë më të vogël (6-16%), sugjerohet që IAL të forcojnë mekanizmat për monitorimin e kostos së studimit në çdo program studimi. Sidoqoftë duhet thënë që ka edhe faktorë të tjerë që kanë ndikim në këtë zgjedhje të nxënësit/studentit, duke provuar që përmirësimi i cilësisë nuk është një proces i lehtë dhe që varet vetëm nga ndërhyrja në një faktor.
- d. Me kurrikulen e re të SHML, vështirësitë më të mëdha, studentet e vitit të parë pohojnë që i kanë ndeshur në lëndën e Fizikës dhe pastaj në atë të Kimisë. Nga ana tjetër, ata kërkojnë mbështetje më të madhe në Matematikë. Organizimi i diskutimeve ndërmjet eksperteve të Matematikës në të dy sistemet, me synim përmirësimin e programit dhe të realizimit, shikohet si rrugë efiçiente. IAL u sugjerohet gjithashtu që të kenë funksional sistemin e tutorazhit dhe të konsultimit sidomos për studentët e vitit të parë.
- e. Në lëndët e zgjedhura, studentët evidentojnë pranimin e fortë të përsëritjeve, ku në vend të parë rendisin Fizikën. Analiza tregoi ndikimin e përgatitjes akademike të nxënësve, edhe në mësimdhënien universitare të vitit të parë. Kjo do të thotë që duhet forcuar bashkëpunimi me sistemin parauniversitar. Rishikimi i hollësishëm i programit të lëndëve, por edhe i metodave të mësimdhënies, konsiderohen shumë të nevojshme.
- f. Futja e programeve të reja në sistemin parauniversitar ka çuar në përmirësimin e Kurrikulës së zgjedhur të nxënësit, që ndikon edhe në suksesin e tij në vitin e parë. Ka një rritje të vogël të notës mesatare, si dhe të kalueshmërisë. Vlerësimi sasior do të duhet të bëhet edhe të paktën për dy vite të tjerë akademike.